

Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara

"Ofrimi i një bote ku secila shtatëzani është e dëshiruar,
çdo lindje e sigurtë
dhe potenciali i çdo të riu i përmbushur."



UNFPA

UNFPA, është agjenci zhvillimore e Kombeve të Bashkuara që promovon qasje universale në shëndetin seksual dhe riprodhues (përfshirë planifikimin familjar) dhe promovon të drejtat e shëndetit riprodhues, redukton mortalitetin e nënave dhe mbështet vendet në përdorimin e të dhënave për politikën dhe programet që kanë qëllim reduktimin e varfërisë dhe për të siguruar të drejtat e çdo gruaje, burri dhe fëmije që të gëzojnë një jetë të shëndetshme dhe mundësi të barabarta.

UNFPA ofron një botë ku secila shtatëzani është e dëshiruar, çdo lindje e sigurtë dhe çdo potencial i ri i përmbushur.

...sepse secili çmohet.

Kosova në përgjithësi

Kosova me popullatë rreth 1.8 milion ka një nga profilet më të reja demografike në Evropë me përafërsisht 50% të popullsisë nën 25 vjeçⁱ. Kosova po ashtu karakterizohet me indikatorët më të ulët të shëndetit të nënës dhe fëmijës në Evropëⁱⁱ.

Statistikat tregojnë se 15% të grave të martuara në moshën riprodhues përdorin kontraktiv modern, derisa 41% të grave të martuara nuk përdorin kurrfarë kontraktivëshⁱⁱⁱ. Të dhënat mbi prevalencën e HIV-it dhe IST-ve nuk ekzistojnë, sidoqoftë, është përlogaritur se incidenca e HIV-it është më e vogël se 1% të popullatës dhe më pak se 5% mes grupeve me rrezik të lartë në Kosovë^{iv}.

Pabarazia gjinore mbetet e lartë dhe gratë kanë pozitë jo të favorshme në shoqëri, po ashtu nivel më të lartë të varfërisë, nivel më të ulët edukimi dhe pjesëmarrje më të vogël në jetën ekonomike dhe politike.

i Regjistrimi i popullsisë dhe vendbanimeve në Kosovë 2011

ii Evaluimi i fundit i projektit të programit të përbashkët "Përmirësimi i shëndetit të gruas dhe fëmijës në Kosovë, 2007-2010 2011

iii Studimi Demografik, Social dhe Shëndetësor 2009

iv Studimi Demografik, Social dhe Shëndetësor 2009

UNFPA në Kosovë

UNFPA vazhdon të fuqizoj kapacitetet e sistemit të kujdesit shëndetësorë që të ofrojë shërbime të shëndetit riprodhues dhe seksual të integruar në kujdesin primarë, sekondarë dhe terciarë, përfshirë planifikimin familjar dhe kujdesin ndaj nënës me fokus të veçantë te të rinjtë dhe grupet më rrezik të lartë.

Zyra e UNFPA në Kosovë vepron për të ndërtuar sistemin shëndetësorë dhe që komunitetet vetvetiu të adresojnë çështjet e lidhura me dhunën e bazuar në gjini (përfshirë dhunën seksuale të të mbijetuarve të luftës). UNFPA po ashtu mbështetë përmirësimin e kapaciteteve kombëtare për të përfshirë dinamikën e popullsisë dhe ndërlidhjen e saj me nevojat e shëndetit riprodhues të grave. Një prioritet tjetër i lartë është për të siguruar që çështjet e lidhura me të rinjtë dhe gjininë të adresohen në mënyrë adekuate brenda planeve dhe programeve të reduktimit të varfërisë.

Shëndeti seksual dhe riprodhues

UNFPA ndihmon për të siguruar prani dhe qasje të shërbimeve cilësore të shëndetit riprodhues bazuar në Strategjinë kombëtare për Nënë, Fëmijën, Adoleshentet dhe Shëndetin Riprodhues, përmes intervenimeve, filluar nga ndërtimi i kapaciteteve të personelit shëndetësorë, zhvillimit dhe adaptimit të plan-programit dhe udhërrëfyesve të shëndetit riprodhues, deri tek përforcimi i partneriteteve institucionale për përmirësimin e qeverisjes së sistemit shëndetësorë në Kosovë.

Ne kemi në cak edukimin e grave, burrave dhe të rinjve duke u ofruar atyre shkathtësi dhe njohuri për jetën mbi shëndetin riprodhues, përfshirë planifikimin familjar përmes organizimit të sesioneve në komunitete dhe sesioneve trajnuese në shkolla, dhe po ashtu përmes sponsorimit të iniciativave për ngritjen e ndërgjegjes rreth çështjeve të ndryshme të popullsisë përmes fushatave, mediave dhe tryezave të rumbullakëta.

UNFPA kontribuon në sigurimin e qasjes ndaj metodave moderne kontraceptive cilësore të përbalueshme në institucionet shëndetësore publike për të gjitha grupmoshat e jetës seksuale aktive. Qasja ndaj këtyre mjeteve u ndihmon dhe lejon gratë dhe burrat të vendosin për numrin dhe shpeshhtësinë e fëmijëve.

UNFPA në Kosovë mbështetë të rinjtë dhe adoleshentët që ata të marrin vendime të informuara rreth jetës seksuale dhe riprodhuese, sepse intervenimet e tilla kanë ndikim pozitiv në shëndet, parandalojnë shpërndarjen e HIV/AIDS dhe infeksionet tjera seksualisht transmissive dhe eliminon numrin e shtatzënësive të palnifikuara të adoleshentëve dhe aborteve të pasigurta. Të rinjtë e informuar dhe edukuar kanë gjasa më të mëdha të arrijnë potencialet e veta.

Promovimi i barazisë gjinore

Në Kosovë, sikur në tërë botën, diskriminimi i bazuar në gjini dhe dhuna i zvogëlojnë mundësitë e grave dhe u pamundësojnë atyre të gëzojnë të drejtat fundamentale njerëzore në mënyrë që ato të luajnë rol të qëndrueshëm në zhvillim dhe eradicimin e varfërisë.

Përveç këtyre, UNFPA avokon që të ofrohen drejtat e plota të shëndetit riprodhues dhe të barabarta pavarësisht gjinisë dhe moshës. UNFPA ka si qëllim përmirësimin e të drejtave të grave dhe femrave të reja duke punuar për të eliminuar dhunën e bazuar në gjini (DHBGJ).

Bazuar në Planin e Veprimit Kombëtar dhe Strategjisë kundër Dhunës në Familje në Kosovë, UNFPA implementon aktivitete për të ndihmuar në minimizimin e DHBGJ:

- Ndërtimin e kapaciteteve institucionale të sektorit shëndetësorë për të adresuar DHBGJ përmes zhvillimit dhe adaptimit të plan-programeve dhe protokolleve për ofruesit e shërbimeve shëndetësore;
- Aktivitetet e bazuara në komunitete për të ngritur vetëdijen e popullsisë rreth pasojave negative dhe të dëmshme të DHBGJ përmes sesioneve bashkëmoshatare të rinjëve, edukimit të bazuar në shfaqje, sesioneve në komunitete, media dhe përmes angazhimit të liderëve fetar;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile që punojnë lidhur me çështjet e DHBGJ dhe duke ndërtuar kapacitetet e tyre për koordinim më të mirë, parandalim, këshillim dhe kujdes për të mbijetuarit;
- Avokimit tek politikë-bërësit rreth DHBGJ në nivelin lokal dhe atë qendror;
- Pjesëmarrje aktive në aktivitetet avokuese të Grupeve të Sigurimit dhe Gjinisë (GSGJ).





Popullata dhe strategjitë zhvillimore

Përgjatë viteve UNFPA në Kosovë ka mbështetur një numër të dokumenteve në lidhje me popullsië dhe zhvillimin, hulumtime, analiza dhe studime të tjera siç janë Ligji mbi Shëndetin Riprodhues; Strategjia e Shëndetit të Nënës, Fëmijës, Adoleshentëve dhe Shëndetit Riprodhues; Hulumtimi Demografik, Social dhe Shëndetin Riprodhues në Kosovë; Raportet mbi Shkaqet e Vdekjeve dhe Regjistrimin e Vdekjeve në Kosovë; Hulumtimi Eksplorativ rreth shtrirjes së Dhunës së Bazuar në Gjini në Kosovë dhe ndikimi i saj në Shëndetin Riprodhues të Gruas; Shtatzënësia dhe Planifikimi Familjar në Kosovë dhe shumë të tjera.

Derisa shtetet janë duke pasur ndryshime në dinamikën e popullsisë, shfaqet nevoja për një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj këtyre trendeve duke implementuar politika dhe strategji adekuate të bazuara në evidencë. Kosova ka popullsinë nga më të rejat në Evropë, por që konsiderohet si një aset vetëm nëse ndërmerren politika dhe veprime adekuate. Prandaj, përmes hulumtimeve, mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave mbi popullatën, UNFPA avokon dhe mbështetë përgatitjen dhe implementimin e strategjive të popllsisë të bazuara në evidencë brenda planifikimit dhe zhvillimit të politikave kombëtare.

Fushata 7 Miliard Veprime e organizuar në vitin 2011, duke bashkuar akterë kyç, vendor dhe ndërkombëtar ngriti ndërgjegjen mbi sfidat dhe mundësitë e trendit të popullsisë në Kosovë dhe globalisht, dhe kryesisht avokoi për implementimin e tyre brenda akterëve kyq.

Partneriteti

UNFPA ka partneritete mirë të zhvilluara me Ministrinë e Shëndetësisë, Qendrën për Zhvillimin e Mjekësisë Familjare, Institutin e Shëndetit Publik, zyrtarët shëndetësorë komunal dhe shoqatat profesionale rreth politikë-bërjen, fuqizimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve shëndetësore në shëndetin riprodhues, të drejtat riprodhuese dhe planifikimit familjar. Organizata e bazuara në Besim, përfshirë Këshillin Islamik Kosovar, dhe Famullinë Katolike janë angazhuar në çështjen e dhunës së bazuar në gjini.

UNFPA punon me parlamentarët në avokim dhe ndërlidhjet e bazuara në evidencë mes dinamikave të popullatës dhe programeve të reduktimit të varfërisë. Po ashtu ka bashkëpunim të vazhduar me Agjencinë Kosovare të Statistikave për të fuqizuar kapacitetet e mbledhjes së të dhënave dhe përdorimin efektiv të tyre në zhvillimin e politikave. Bashkëpunimi me media i përket një komponentë esenciale të avokimit të UNFPA-së.

Partneriteti me shoqërinë civile dhe organizatat jo-qeveritare është pjesë vitale e punës së UNFPA-së në Kosovë. Bashkëpunimi është i vënë me OJQ të ndryshme që punojnë në fushën e të rinjve, shëndetit riprodhues përfshirë planifikimin familjar, barazinë gjinore dhe hulumtimet.

Gjithashtu, UNFPA si anëtar i Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë punon së bashku me agjenci të tjera të KB në adresimin e sfidave zhvillimore në Kosovë në arritjen e objektivave të vëna në Synimet Zhvillimore të Mileniumit dhe Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullsinë dhe Zhvillimin (ICPD-KNPZH) Pas 2014 . Një shembull konkret i harmonizimit dhe koordinimit të UNFPA-së dhe agjencive të tjera të KB është Plani i Përbashkët i UN Agjensioneve në Kosovë 2012-2015 si dhe zhvillimi një numri të konsiderueshëm i programeve të përbashkëta.

Të dhëna faktike

POPULATION	1990	Të fundit
Popullata totale në mijëra	1 560 [^] 1999	1 740 2011
Popullata totale në mijëra, meshkuj	-	874 2011
Popullata totale në mijëra, femra	-	864 2011
Popullata totale, 0-14, %	33.1 2003	28.0 2011
Popullata totale, 15-59, %	60.5 2003	62.2 2011
Popullata totale, 60+, %	6.4 2003	9.8 2011
Shkalla totale e Fertilitetit (TFR)	2.98 2003	2.0 2009
Jetëgjatësia në lindje, meshkuj, vite [#]	65.7 2002	67.9 2010
Jetëgjatësia në lindje, femra, vite [#]	70.3 2002	72 2010
Shkalla totale e varësisë (0-14+65+/15-64)	-	53.2 2011
SHËNDETI SEKSUAL DHE RIPRODHUES	1990	Të fundit
Të dhënat maternale për 100 000 lindje të gjalla	-	11.7 2011
Shkalla e abortit për 1000 lindje të gjalla	4.8 ^{^^} 1999	-
Kujdesi antenatal, së paku 4 vizita	-	78.1 ^{^^} 2009
Shkalla e prevalencës kontraceptive, të gjithë, %	18.9 [^] 1999	35.2 2009
Shkalla e prevalencës kontraceptive, modern, %	8.8 [^] 1999	9.2 2009
GJINIA	1990	Të fundit
Ulëset që mbahen nga gratë në parlament %	-	32.5 2012
Numri i grave të punësuar (me pagë) (sektori jo agrikorik)	28.0 [^] 1999	24.3 2011
Indeksi i paritetit gjinor në regjistrin sekondar	-	0.88 2011
HIV dhe IST të tjera*	1990	Të fundit
Përqindja e meshkujve që kanë seks me meshkuj në kryeqytet që janë të infektuar me HIV	-	0 2011
Përqindja e punëtorëve të seksit që raportojnë përdorimin e kondomit me klientin e fundit	35.0 2006	42.5 2011
Përqindja e meshkujve që raportojnë përdorimin e kondomit herën e fundit që kanë pasur seks anal me partner mashkull	56.0 2006	52.5 2011
Përqindja e punëtorëve të seksit me njohuri korrekte rreth transmetimit të HIV	-	13.0 2011
Përqindja e meshkujve që kanë seks me meshkuj me njohuri korrekte rreth transmetimit të HIV	-	26.9 2011
Përqindja e njerëzve që injektojnë barna me njohuri korrekte rreth transmetimit të HIV	-	22.0 2011

Burimi i të dhënave:

Agjencia Kosovare e Statistikave

Të dhënat nga Banka Botërore

^^ Studimi Demografik, Social dhe Shëndetësor 1999

^ Kujdesi Antenatal në Kosovë 2009

* UNGASS

Tanzicioni Demografik në Kosovë: Sfidat dhe Mundësitë në Botën me 7 miliardë banorëve





United Nation Population Fund

Phone: +38138 249 088

Fax: +381 38 249 089

Pejton City, Mujo Ulqinaku 7,

Prishtina, 10000, Kosovo

Website: www.unfpakos.org